# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6941
E martë, 11 korrik 2023
Çmimi 0.40


## BE-në do ta lehtësonte shuarja e Ballkanit të Hapur

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


OPOZITA PARLAMENTARE VAZHDON TË INSISTOJË QË KOSOVA TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA PARLAMENTARE FAQE 4-5

# OPOZITA KËRKON SHPËRBËRJEN E KUVENDIT: ËSHTË KOHA QË VENDI TË SHKOJË NË ZGJEDHJE



Opozita është duke insistuar që Kosova të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka kërkuar nga deputetët të pajtohen për shpërndarjen e Kuvendit në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Ai në Kuvendin e Kosovës ka thënë se vendi është në bllokadë për shkak të qeverisë Kurti. "Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja sa më shpejt!", ka thënë Krasniqi. Ndaj kësaj kërkese me ironi ka reaguar kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i cili i ka thënë Krasniqit që të mos e provokojë pushtetin për zgjedhje. Mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare e ka kërkuar edhe shefi i deputetëve të AAK-së, Besnik Tahiri, i cili ka kërkuar të përkrahet mocioni për rrëzimin e qeverisë Kurti

## DALIN PËRGJIMET, KUSARI-LILA PRANON SE KA BISEDUAR ME MILAN RADOJIÇIQIN, NJERIUN QË ËSHTË NË LISTËN E ZEZË TË AMERIKËS

FAQE 3




## NIÇ: KOSOVA MË AFËR KONFLIKTIT TË HAPUR SESA BOSNJA

FAQE 3



## AKTUALE



### BIDENI: UKRAINA NUK MUND TË ANËTARËSOHET NË NATO PARA PËRFUNDIMIT TË LUFTËS F. 2

### KUVENDI I KOSOVËS MBAN NJË MINUTË HESHTJE NË KUJTIM TË GJENOCIDIT NË SREBRENICË F. 3

### KURTI VIZITON IPESHKVINË E KOSOVËS, DISKUTOHET PËR LIGJIN PËR LIRITË FETARE F. 7

### BUSTI I MADELEINE ALBRIGHTIT SË SHPEJTI DO TË VENDOSET NË QYTETIN E SKENDERAJT F. 6

## EKONOMI



### QEVERIA E KOSOVËS 'ZBUT' MASËN E SIGURISË PËR MALLRAT SERBE F. 8

### HAPET APLIKIMI PËR PAGESA DIREKTE NË SEKTORIN E BLEGTORISË F. 8

## SPORT



### DAJA DHE THAQI: VËSHTIRË NDAJ LUDOGORETSIT, POR NUK DORËZOHEMI F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Bideni: Ukraina nuk mund të anëtarësohet në NATO para përfundimit të luftës

**UASHINGTON, 10 KORRIK** - Përpara se të nisej për në samitin e NATO-s, presidenti i amerikan Joe Biden tha se Ukraina nuk është gati për anëtarësim në aleancë, duke pohuar se lufta me Rusinë duhet të përfundojë përpara se vendi të marrë një ftesë për anëtarësim.
Më 9 korrik, gjatë një interviste për CNN-in, Bideni u shpreh se, megjithëse është herët të flitet për përfshirjen e Ukrainës në Aleancë, Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e tjerë të NATO-s do të vazhdojnë ta furnizojnë Kievin me armët e nevojshme për t'u mbrojtur kundër pushtimit të pajustifikuar rus.
Kjo intervistë u realizua para nisjes së Bidenit për një turne në tre vende të Evropës.
Bideni foli përpara udhëtimit të tij një javor, i cili fillon në Londër, më pas shkon në Vilnius të Lituanisë për samitin e NATO-s më 11 dhe 12 korrik, në fund shkon në Finlandë për t'u takuar me udhëheqësit e anëtarit më të ri të NATO-s. "Unë nuk mendoj se ka unanimitet në NATO se a duhet të anëtarësohet Ukraina në familjen e NATO-s tani, në këtë moment, në mes të një lufte", tha Bideni. "Ne jemi të vendosur të angazhohemi në çdo centimetër të territorit që është territor i NATO-s. Është një angazhim që ne të gjithë e kemi bërë pa marrë parasysh çfarë ndodh. Nëse lufta po vazhdon, atëherë të gjithë jemi në luftë", tha Bideni.
Bideni shtoi se ka folur shpesh me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky për situatën e NATO-s dhe tha se e ka siguruar atë për mbështetjen e Uashingtonit në mbrojtje kundër agresionit rus. "Unë mendoj se ne duhet të përcaktojmë një rrugë racionale për Ukrainën që të jetë në gjendje të kualifikohet për të qenë në gjendje që të hyjë në NATO", tha Biden.
Në një intervistë të gjatë me ABC News nga Kievi më 9 korrik, Zelensky përsëriti se ai "kurrë" nuk do t'i dorëzojë asnjë territor Rusisë, duke përfshirë Gadishullin e Krimesë, të cilin Kremlini e aneksoi ilegalisht në vitin 2014.
Ai nuk e kundërshtoi një raport të "Washington Post"-it se zyrtarët ukrainas i thanë drejtorit të CIA-s, William Burns, gjatë një udhëtimi të fundit në Kiev, se qëllimi i kundërofensivës aktuale ishte afrimi te Krimea, diçka që besohet se mund ta detyronte presidentin rus Vladimir Putin të ulej në tryezë për negociata. "Ka shumë gjasa që Putini do të detyrohet të kërkojë



dialog me botën e qytetëruar, ndryshe nga sa ishte përpara pushtimi në shkallë të gjerë, sepse ai do të dobësohet", tha Zelensky.
Më vonë, më 9 korrik, Bideni foli në telefon me presidentin turk Rexhep Tajip Erdogan, në të cilën ata diskutuan për mundësinë e anëtarësimit të Suedisë në NATO, tha presidenca turke.
Erdogani i tha Bidenit se Stokholmi kishte ndërmarrë hapat e duhur që Ankaraja ta ratifikonte kërkesën e saj për anëtarësim, duke iu referuar një ligji kundër terrorizmit, por se këta hapa nuk ishin të dobishëm, pasi mbështetësit e Partisë Punëtore të Kurdistanit (PKK) vazhduan të mbanin demonstrata në Suedi.
Të dy presidentët diskutuan edhe për dërgimin e avionëve luftarakë F-16 dhe statusin e Ukrainës në NATO, teksa thanë se do të takohen personalisht në samitin e NATO-s në Vilnius.

# Rreth 47 000 ushtarë rusë të vrarë në Ukrainë, thotë hulumtimi i pavarur

**KIEV, 10 KORRIK** - Sipas analizës së parë statistikore të pavarur, rreth 47 000 burra rusë kanë vdekur në luftën në Ukrainë, e cila filloi në shkurt të vitit 2022.
Agjencia e lajmeve "Assocciated Press" raporton se mediet ruse "Mediazona" dhe "Meduza", në bashkëpunim me një hulumtues të të dhënave nga Universiteti Tubingen në Gjermani, hulumtuan regjistrin e vdekshmërinë për ta vlerësuar numrin e vdekjeve shtesë te burrat nën 50 vjeç midis muajit shkurt të vitit 2022 dhe majit të vitit 2023, krahasuar me vitet paraprake.
Ata analizuan të dhënat e trashëgimisë dhe të dhënat zyrtare të vdekshmërisë për të hedhur dritë mbi koston e vërtetë njerëzore të pushtimit rus të Ukrainës.
Si Moska, ashtu edhe Kievi, nuk japin të dhëna në kohë reale për humbjet ushtarake dhe përpiqen ta zvogëlojnë numrin viktimave të palës tjetër.
Qeveria ruse ka pranuar zyrtarisht vdekjen e pak më shumë se 6 000 ushtarëve, por raportet për humbjet ushtarake janë shtypur në mediet ruse.
Pavarësisht prej sfidave,



"Mediazona", shërbimi rus i BBC-së dhe një rrjet vullnetarësh, kanë ndërtuar një bazë të dhënash të vdekjeve të konfirmuara të luftës duke përdorur postime në rrjete sociale dhe fotografi të varrezave në të gjithë Rusinë.
Që nga 7 korriku ata kishin identifikuar 27 423 ushtarë rusë të vrarë.
Për të arritur një raport më të plotë, "Mediazona" dhe "Meduza" morën të dhënat e rasteve të trashëgimisë të depozituara pranë autoriteteve ruse.
Analiza e tyre zbuloi se në vitin 2022 ishin hapur 25 000 më shumë raste të trashëgimisë për meshkujt e moshës 15 deri në 49 vjeç sesa pritej, dhe deri më 27 maj 2023 numri i rasteve ishte rritur në 47 000.
Këto shifra përputhen me vlerësimet e bëra nga agjencitë e inteligjencës së ShBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, të cilat vlerësuan se numri i vdekjeve ruse në luftë ishte midis 35 000 dhe 60 000.
Analiza theksoi gjithashtu mungesën e transparencës në lidhje me viktimat midis fraksioneve të ndryshme të përfshira në konflikt, si kompanitë private ushtarake dhe të burgosurit e rekrutuar nga Ministria ruse e Mbrojtjes.
Shkencëtarët e të dhënave pranuan se ekzistojnë pasiguri dhe manipulime të mundshme, veçanërisht në lidhje me ushtarët e zhdukur dhe vdekjet e burrave të moshuar. Megjithatë, ata besojnë se rezultatet e përgjithshme janë të besueshme.
Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar vuri në dukje se Rusia ka përjetuar rreth 400 viktima në ditë për 17 muaj, duke çuar në një krizë në kujdesin mjekësor.
Është e rëndësishme të theksohet se analiza nuk përfshin rusët e zhdukur, të cilët nuk njihen zyrtarisht si të vdekur, as nuk përfshin qytetarët ukrainas që luftojnë në njësitë separatiste.
Ministria ruse e Mbrojtjes nuk dha një përgjigje të menjëhershme për analizën.
"Mediazona" dhe "Meduza" janë media të pavarura ruse që veprojnë në azil, duke u përballur me kufizime dhe censurë nga qeveria ruse.
Të dyja mediet janë shpallur "agjentë të huaj" nga autoritetet ruse, dhe uebfaqjet e tyre janë të bllokuara në Rusi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Dalin përgjimet, Kusari-Lila pranon se ka biseduar me Milan Radojiçiqin, njeriun që është në listën e zezë të Amerikës

Prishtinë, 10 korrik - Gazeta Nacionale ka publikuar pjesën e parë të përgjimit të bisedave të shefes së grupit parlamentar të LV-së, Mimoza Kusari-Lilës, me deputetin e Listës Serbe, Slavko Simiq.

Gazetari Berat Buzhala në hyrjen e përgjimeve të para ka zbuluar se këto incizime janë bërë në qershor të vitit të kaluar. Biseda ndërmjet Kusari-Lilës e Slavko Simiqit është bërë në zyrën e shefes së grupit parlamentar të Vetëvendosjes.

Në hyrje të bisedës, Slavko Simiq ia përmend Kusari-Lilës një bisedë që kjo e fundit e ka bërë me Milan Radojiçiqin, njeriun në listën e zezë të Amerikës, i dyshuar për vrasjen e Oliver Ivanoviqit dhe i dyshuar për rastin Brezovica.

Në atë moment Kusari-Lila ndërhyn duke i thënë "3-4 minuta". Pra, duke pretenduar se nuk ka biseduar me Radojiçiqin 30-40 minuta, por 3-4 minuta, raporton ekskluzivisht Nacionale.

Në përgjimet e tjera që do të publikohen në ditët në vazhdim, Kusari-lila koordinohet me Listën Serbe për temën e veteranëve, i ofendon kolegët e vet nga partitë në opozitë dhe një letër që Radojiçiq ia ka përcjellë shefes së grupit parlamentar të Vetëvendosjes.

Slavko Simiq dëgjohet teksa i thotë Kusari-Lilës se ne që nga fillimi kemi pasur raport partnerësh. Këtë shefja e deputetëve të LV-së nuk e mohon asnjëherë.




# Kuvendi i Kosovës mban një minutë heshtje në kujtim të gjenocidit në Srebrenicë

Prishtinë, 10 korrik - Më 10 korrik seanca e Kuvendit të Kosovës filloi me një minutë heshtje për t'i nderuar viktimat e gjenocidit në Srebrenicë në Bosnjë-Hercegovinë.

Deputeti i komunitetit boshnjak para koalicionit Vakat, Bahrim Shabani, tha se Kosova qëndron në krah të popullit të Bosnjë-Hercegovinës dhe tha se mohimi i gjenocidit nuk guxon të lejohet dhe të tolerohet. "Shteti i Kosovës dhe boshnjakët e Kosovës janë të përkushtuar për ruajtjen e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës si shtet sovran, i pavarur dhe i pandashëm", tha ai.



Duda Bale, deputete boshnjake e Kuvendit të Kosovës, përfaqësuese e Unionit Socialdemokrat, shprehu shpresën e saj se një gjenocid si ai i Srebrenicës nuk do të përsëritet më.

Në vitin 2021 Kuvendi i Kosovës miratoi edhe Rezolutën për Srebrenicën, e cila dënon gjenocidin e regjimit serb në Srebrenicë kundër pjesëtarëve të popullit boshnjak, konfirmon masakrën e më shumë se 8 000 burrave dhe djemve boshnjakë dhe dënon ashpër mohimin e gjenocidit.

Kjo rezolutë parashikon se 11 korriku do të shënohet në Kosovë si "Dita e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë".

Në vitin 2007 Gjykata Ndërkombëtare në Hagë vendosi se në Srebrenicë ishte kryer gjenocid.

Më 8 qershor 2021 gjyqtarët e gjykatës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara konfirmuan në procedurën e shkallës së dytë aktgjykimin me të cilin ish-komandanti i Ushtrisë së Republikës Sërpska, Ratko Mlladiq, u dënua me burgim të përjetshëm për gjenocidin në Srebrenicë, përndjekje, krime kundër njerëzimit, shfarosje dhe krime të tjera lufte në Bosnjë-Hercegovinë nga viti 1992 deri në 1995.

Ende kërkohet për rreth 1 000 mbetje dhe këtë vit do të varrosen 30 trupa jo të plotë të gjenocidit të Srebrenicës.

Mbetjet mortore u gjetën në disa varre që anëtarët e Ushtrisë së Republikës Sërpska i gërmuan vazhdimisht dhe i zhvendosën kufomat për t'i mbuluar gjurmët e krimit.

# Niç: Kosova më afër konfliktit të hapur sesa Bosnja

Prishtinë, 10 korrik - Udhëheqësit e NATO-s pritet të konfirmojnë në samitin në Vilnius se situata në Kosovë është serioze dhe se misioni i NATO-s, KFOR, është atje për ta garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe atë të pakicës serbe në veri, thotë Milan Niç nga Këshilli Gjerman për Marrëdhënie me Jashtë.



Duke folur në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, Niç thotë se telashet do të ishin shumë më të mëdha nëse NATO-ja nuk do të ishte në Kosovë. "Mendoj se [Kosova] është më afër një konflikti të hapur sesa Bosnja. Dhe është një nivel ndryshe i konfliktit, sepse keni sulme fizike ose konfrontime në veri, keni struktura paralele, keni shpërthime, ku një incident i vogël mund të çojë në diçka më të madhe", ka theksuar Niç, ekspert për Ballkanin Perëndimor dhe zgjerimin e NATO-s.

Duke u ndalur te Serbia, ai thotë se presidenti i saj, Aleksandër Vuçiq, mund ta luajë edhe për kohë të gjatë lojën "edhe Perëndimi, edhe Rusia". Ndërkaq duke folur për samitin në Vilnius, ai tha se pritet të dalë edhe një deklaratë nga NATO-ja për situatën në veri.

"Nëse flasim për samitin në Vilnius, mendoj se do të ketë një rikonfirmim në deklaratë se situata është serioze dhe se NATO-ja është atje për ta garantuar sigurinë e të gjithë qytetarëve, përfshirë këtu edhe pakicën serbe në veri. Është çështje e Qeverisë së Kosovës se deri në çfarë mase do që të jetë në aleancë me mbështetësit e saj kryesorë në Perëndim dhe t'i bashkërendojë me ta hapat diplomatikë edhe ndaj Serbisë. Sepse, në fund të fundit, ka të bëjë me koordinimin dhe ndërtimin e aleancave. Dhe historia e Qeverisë aktuale të Kosovës në këtë drejtim nuk është shumë e mirë", ka thënë Niç.

## Osmani kërkon mbështetjen e UNDP-së për projekte të ndryshme

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 10 korrik - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesin e UNDP-së në Kosovë, Nuno Querios, të cilit i ka uruar mirëseardhje dhe ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në projektet të cilat do të zbatohen në Kosovë nga UNDP-ja.

Gjatë takimit Osmani vlerësoi lart kontributin e UNDP-së në mbështetjen e shumë programeve dhe projekteve në Kosovë, me theks të veçantë tek ato për gratë, rininë, mjedisin dhe personat me nevoja të veçanta.

Presidentja Osmani kërkoi mbështetje për projektet të cilat janë ndër prioritetet e mandatit të saj, të cilat përfshinë fuqizimin ekonomik të grave, përkrahjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe agjendën e gjelbër.

Ndërsa përfaqësuesi i UNDP-s u shpreh i hapur për të bashkëpunuar për t'i përkrahur këto prioritete duke marrë parasysh edhe projektet e ngjashme që po zhvillohen në rajon.

Ndër të tjera, u diskutua edhe për Forumin për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, i cili organizohet nga presidentja Osmani.

Presidentja falënderoi UNDP-në për partneritetin dhe bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe nga ky takim u riikonfirmua mbështetja edhe për këtë vit.





OPOZITA PARLAMENTARE VAZHDON TË INSISTOJË QË KOSOVA TË SHKOJË NË ZGJEDHJE TË REJA PARLAMENTARE

# Opozita kërkon shpërbërjen e Kuvendit: Është koha që vendi të shkojë në zgjedhje

Opozita është duke insistuar që Kosova të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka kërkuar nga deputetët të pajtohen për shpërndarjen e Kuvendit në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Ai në Kuvendin e Kosovës ka thënë se vendi është në bllokadë për shkak të qeverisë Kurti. "Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja sa më shpejt!", ka thënë Krasniqi. Ndaj kësaj kërkese me ironi ka reaguar kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, i cili i ka thënë Krasniqit që të mos e provokojë pushtetin për zgjedhje. Mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare e ka kërkuar edhe shefi i deputetëve të AAK-së, Besnik Tahiri, i cili ka kërkuar të përkrahet mocioni për rrëzimin e qeverisë Kurti

EPOKA E RE **Lirim GECI**

**PRISHTINË, 10 KORRIK -** Kohën e fundit janë shtuar zërat për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare. Duke e parë situatën në të cilën gjendet Kosova nën drejtimin e kryeministrit Albin Kurti, partitë opozitare janë duke kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka kërkuar nga deputetët të pajtohen për shpërndarjen e Kuvendit në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Ai në Kuvendin e Kosovës ka thënë se vendi është në bllokadë për shkak të qeverisë Kurti. "Ky Kuvend nuk duhet ta vazhdojë punën. Ju ftoj publikisht të merremi vesh të bëjmë një mocion, ta shpërndajmë Kuvendin e Kosovës. Kjo legjislaturë nuk është në gjendje të kalojë asgjë, është një bllokim i punës së brendshme, e mos të flasim edhe për punën e jashtme që me sanksione e keni bllokuar Kosovën. Me 80 vota duhet ta dërgojmë vendin në zgjedhje dhe ta zhbëjmë këtë Kuvend", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja sa më shpejt!

### Konjufca, opozitës: A dëshironi të bëheni bashkë? Mos e provokoni mazhorancën

Me këtë rast, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pasur replika me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, pasi ky i fundit ka thënë se Kuvendi nuk po arrin të votojë asnjë projektligj prandaj, sipas tij, zgjidhja më e mirë është shpërndarja e tij dhe shkuarja në zgjedhje të reja. Konjufca ka thënë se zgjedhjet mund të bëhen vetëm sipas afateve ligjore.
Madje ai ka sjellë në kujtesën e deputetëve edhe një fjali të tij që dikur e kishte bërë për opozitën në një emision televiziv, kur kishte thënë "a dëshironi të bëheni bashkë". "Mos më detyroni. Kjo është arsyeja që sot keni ardhur 90 deputetë a? Pasi me dy të tretat mos e provokoni mazhorancës, se këta votojnë për të shkuar në zgjedhje. Nesër zgjedhjet nuk munden me ndodh. Ato e kanë afatin. A po ju kujtohet parvjet me një emision çka ju pata thanë?", ka thënë Konjufca.
Mbajtjen e zgjedhjeve të reja e ka kërkuar edhe shefi i deputetëve të PDK-së, Abelard Tahiri. Ai ka thënë se është koha që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme. "Ky Kuvend nuk e meriton as edhe një ditë të vetme t'i shfrytëzojë taksat e qytetarëve kur është kaq jofunksional. Si grup parlamentar i PDK-së dhe si parti tashmë kemi një vendim ku ne kërkojmë që ky Kuvend jofunksional i cili po i shkakton më shumë dëm kësaj republike sesa po ndihmon në një qeverisje të mirë, duhet të shpërbëhet sa më parë. I kemi dhënë edhe mundësinë kryeministrit nga java e kaluar ose ta shpërbëjë Kuvendin ose të japë dorëheqje, dhe koha është që vendi ynë të shkojë në zgjedhje të parakohshme", ka thënë Tahiri pas dëshmimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. Më tutje, ai ka bërë me dije se si grup parlamentar nuk do të votojnë asnjë marrëveshje në Kuvend. "Ne nuk mund të mbijetojmë të izoluar dhe nuk e kemi ndërmend ta ndihmojmë izolimin. Ne si grup nuk do të votojmë as marrëveshjet ndërkombëtare, as projektligjet, as strategjitë, me qëllimin e vetëm që sa më shpejt ta dërgojmë vendin në →

# BE-në do ta lehtësonte shuarja e Ballkanit të Hapur



Prishtinë, 10 korrik - Paralajmërimi i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, për shkrirjen e ideve të nismës Ballkani i Hapur në Procesin e Berlinit, do të mirëpritej nga shumë qarqe në Bashkimin Evropian.

Deri më tash Rama është shprehur vetëm në media se Ballkani i Hapur "e ka përmbyllur misionin e tij" dhe se idetë e kësaj nisme do të barten në Procesin e Berlinit. Në BE nuk ka pasur reagime zyrtare rreth këtij paralajmërimi por, jozyrtarisht, disa diplomatë evropianë thonë për "Radion Evropa e Lirë" se "kjo do të mirëpritej" dhe se "do të ishte një lehtësim i madh për forcimin e Procesit të Berlinit dhe të proceseve të tjera".

Nisma Ballkani i Hapur, e cila fillimisht është quajtur Mini Schengen, është ndërmarrë më 10 tetor 2019 në Novi Sad dhe është nënshkruar nga presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministri i atëhershëm i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev.

Nisma është kundërshtuar nga opozita në Shqipëri dhe është refuzuar nga Kosova, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina.

Në kuadër të saj janë arritur disa marrëveshje si për bashkëpunim ekonomik dhe lëvizje të lirë. Lidhur me paralajmërimin e Ramës për shuarjen e saj, Vuçiqi ka thënë se "nuk mund ta besojë se ai [Rama] e ka thënë një gjë të tillë". Në Maqedoninë e Veriut nuk ka pasur ndonjë reagim.

### Cili ka qenë qëndrimi i BE-së?

BE-ja ka qenë vazhdimisht e paqartë rreth kësaj nisme.

Formalisht, nuk është shprehur kundër sepse, në parim, mbështet çdo nismë që ka për qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal. Por, në anën tjetër, shumë qarqe në BE e kanë parë atë si dublifikim i proceseve ekzistuese, si: Tregu i Përbashkët Rajonal, Procesi i Berlinit, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Marrëveshja për Tregti të Lirë - CEFTA e të tjera.

Në pyetjen se a e mbështetin nismën Ballkani i Hapur, në BE gjithmonë janë përgjigjur duke thënë se e "mbështetin çdo nismë për bashkëpunim rajonal, e cila është gjithëpërfshirëse" dhe në të cilën janë "të gjashtë partnerët nga rajoni i Ballkanit Perëndimor".

Marrë parasysh se në nismën Ballkani i Hapur, edhe pas disa vjetësh, kanë mbetur vetëm tri vende anëtare, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut, për të nuk mund të thuhet se është gjithëpërfshirëse. Prandaj, shumë diplomatë në BE, jozyrtarisht, kanë shprehur qëndrimin se kjo nismë nuk e ka mbështetjen e plotë.

Në vend të kësaj, nga BE-ja është bërë thirrje që vendet e rajonit të fokusohen në Procesin e Berlinit, edhe pse as ai proces formalisht nuk është në kuadër të veprimit institucional të Bashkimit Evropian.

Nismën Ballkani i Hapur ndërkohë e kanë mbështetur vende si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqia dhe Hungaria, të cilat kanë dërguar edhe zyrtarë të tyre në takimet e saj.

Edhe komisionari i BE-së për Fqinjësi dhe Zgjerim, Oliver Varhelyi, ka folur në disa takime të Ballkanit të Hapur.

Nga ana tjetër, Procesi i Berlinit ka fituar një mbështetje të plotë nga të gjashtë shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor ashtu si edhe mbështetje ndërkombëtare.

Qëllimi i kësaj nisme ndërqeveritare është t'i lidhë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimin Evropian dhe t'i ndihmojë të ndërtojnë marrëdhënie të ndërsjella mbi bazën e vlerave evropiane.

BE-ja ka qenë shumë aktive në mbështetjen e këtij procesi, duke u treguar e gatshme edhe për bashkëfinancimin e disa projekteve.

Procesi i Berlinit përfshin të gjashtë shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, duke i cilësuar të gjitha si shtete, për dallim nga disa procese të tjera, ku BE-ja apo vendet e rajonit kanë rolin kryesor dhe ku - për shkak të Kosovës që nuk njihet nga Serbia dhe Bosnja - ato quhen "partnere" apo "gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor".

Procesi i Berlinit është nismë gjermane, e mbështetur edhe nga shumë shtete të tjera të BE-së, si: Gjermania, Franca, Italia, Austria, Kroacia, Bullgaria, Sllovenia, Polonia dhe Greqia. Edhe pse nuk është më anëtare e BE-së, pjesë e procesit vazhdon të jetë edhe Britania e Madhe.

Të gjitha këto vende janë shprehur të gatshme ta japin kontributin e tyre për t'i ndihmuar shtetet e Ballkanit Perëndimor në përpjekjet e tyre për zhvillim dhe afrim me standardet e BE-së.

Në samitet e Procesit të Berlinit kanë marrë pjesë edhe liderët e institucioneve të Bashkimit Evropian, përfshirë presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel, dhe presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Procesi i Berlinit ka nisur si ide e ish-kancelares gjermane Angela Merkel. Por, edhe pasardhësi i saj, Olaf Scholz, ka vendosur ta mbajë këtë proces si prioritet. Ai ka qenë mikpritës dhe organizator i një samiti, ku janë nënshkruar disa marrëveshje kyçe mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Deklaratat e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, i cili edhe do të jetë mikpritës i samitit të radhës të Procesit të Berlinit, shihen nga shumë diplomatë në BE si mundësi për "rrugëdalje të ndershme". Sipas tyre, tri vendet e Ballkanit të Hapur do të mund të thonë se kjo ide "nuk ka qenë e kotë" dhe se ajo "do ta begatojë Procesin e Berlinit".

Ndërkohë, siç thonë diplomatët, do të hiqet edhe presioni ndaj Kosovës, Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës që t'i bashkohen një procesi, të cilit nuk i janë bashkuar deri më tash.

Në Kosovë të gjitha qeveritë kanë qenë kundër Ballkanit të Hapur, ndërsa në Bosnjë-Hercegovinë ka pasur mospajtime të brendshme për shkak të të cilave vendi nuk ka mundur të bëhet pjesë.

Qeveria e kaluar e Malit të Zi ka qenë kundër, ndërsa fituesit e zgjedhjeve të qershorit kanë shprehur gatishmërinë ta shqyrtojnë pjesëmarrjen në Ballkanin e Hapur. Megjithatë, edhe në Mal të Zi kjo çështje ka krijuar ndasi në spektrin e brendshëm politik.

---

zgjedhje dhe ta largojmë këtë qeveri të paaftë", ka thënë Tahiri.

### Shefi i deputetëve të AAK-së kërkon të përkrahet mocioni për rrëzimin e qeverisë Kurti

Edhe shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka kërkuar që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Në këtë kontekst, ai ka kërkuar që të votohet mocioni i AAK-së për rrëzimin e qeverisë Kurti. "Kurti e ka izoluar Kosovën. Nuk është duke e parë pasqyrën. Është ngujuar në një kabinet të vetin dhe është duke e dërguar Kosovën në një humnerë, dhe kjo duhet të ndalet. Mënyra e vetme për t'u ndalur është kthimi te kërkesa jonë për mocion dhe shkuarja në zgjedhje. Mocioni ynë është diskuar para se të bëhet publik", ka thënë Tahiri pas dështimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Ai ka thënë se qeveria është duke vazhduar deklaratat dhe veprimet skandaloze dhe se, sipas tij, Kosova është në qorrsokak. "Si grup parlamentar nuk kemi marrë pjesë në Kryesi dhe mendojmë që të gjitha votimet në të gjitha nivelet, duke filluar nga kryesia, komisionet dhe seancat, nuk do të ndodhin. Arsyeja është e thjeshtë: vendi është në një qorrsokak. Zgjidhja e vetme është mocioni i cili do të prodhojë zgjedhje. Rrugë tjetër nuk ka", ka thënë Tahiri.

Shefi i deputetëve i AAK-së ka thënë se ka biseduar edhe me kolegët e tij për votimin e mocionit kundër qeverisë Kurti. "Unë kam diskutuar me shefa të grupeve. Kam pasur takim me shefat e grupeve dhe i kam njoftuar. Ata kanë gatishmëri, mirëpo brengën e kanë sa a u bëhen votat. Mendoj se votat bëhen nëse e marrim edhe mbështetjen e opozitës", ka thënë Tahiri.

Kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja vjen si pasojë e situatës në veri, prishjes së raporteve të qeverisë Kurti me partnerët ndërkombëtarë dhe vendosjes së masave nga Bashkimi Evropian (BE) kundër Kosovës.

## Nga 15 korriku do të mbyllet për automjete rruga 'Dardania' në Fushë-Kosovë

Fushë-Kosovë, 10 korrik - Komuna e Fushë-Kosovës ka njoftuar qytetarët e saj se nga 15 korriku deri më 25 gusht do të mbyllet segmenti rrugor nga shkolla "Mihal Grameno" deri te rruga "Pajazit Islami" në rrugën "Dardania" për lëvizjen e të gjitha automjeteve në periudhën kohore 20:00-24:00. Komuna e Fushë-Kosovës ka njoftuar se organet kompetente komunale dhe Policia e Kosovës do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për shenjëzimin dhe respektimin e vendimit.



# Rikthehet në Mitrovicë monumenti artistik "Barazi, punë, dije"

Mitrovicë, 10 korrik - Në praninë e shumë qytetarëve, artistëve vendorë dhe ndërkombëtarë, u inaugurua monumenti artistik "Barazi, punë, dije".
Kryetari i komunës, Bedri Hamza, në fjalën përshëndetëse të tij, e falënderoi artistin mitrovicas me renome ndërkombëtare për punën dhe bashkëpunimin e shkëlqyeshëm, bashkë me Autostradën Bienale ku edhe u prodhua kjo vepër artistike e cila i mungonte hapësirës publike të qytetit të Mitrovicës.
Hamza pasi e falënderoi Albanin dhe artistët lokalë për punën e bashkëpunimin, e që i quajti ambasadorët më të mirë të vendit, ai premtoi më shumë përkrahje për kulturën pasi, që siç tha ai, kultura është shtylla kyçe e zhvillimit.
Alban Muja shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me komunën e Mitrovicës dhe Autostradën Bienale, që e kanë përfshirë Mitrovicën në agjendën e tyre. Ai, po ashtu, falënderoi edhe kuratorët ndërkombëtarë të cilat ishin të pranishëm bashkë me dhjetëra artistë të tjerë të huaj.
Udhëheqësi i Autostradës, Leutrim Fishekqiu, u shpreh tejet i lumtur që bashkëpunimi me Alban Mujën dhe komunën e Mitrovicës u kurorëzua me kthimin e kësaj vepre artistike në shtëpi të vet dhe u përmbyll programi i jashtëzakonshëm i Autostradës Bienale 4, pikërisht në Mitrovicë dhe pikërisht në këtë kohë.
Kjo vepër artistike u realizua nga artisti Alban Muja, në rikujtim të monumentit artistik që ishte pjesë e memories kolektive mitrovicase, si dhe u prodhua nga Autostrada Bienale me përkrahje nga komuna e Mitrovicës.



# Busti i Madeleine Albrightit së shpejti do të vendoset në qytetin e Skenderajt



Skenderaj, 10 korrik - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka njoftuar se busti i ish-sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Madeleine Albright, së shpejti do të vendoset në njërën nga pjesët më të frekuentuara të qytetit të kësaj komune.
Nura është shprehur se nderimi i figurës së Albrightit është obligim për ta shprehur mirënjohjen e pakufishme ndaj kontributit të saj për lirinë e Kosovës. "Detajet e fundit të një pune mjeshtërore dhe madhështore, po aq sa është vetë figura e Madeleine Albright, busti i së cilës po merr formë duke i ngjarë milimetrisht pamjes së paharruar të saj, si një obligim yni për ta shprehur mirënjohjen e pakufishme ndaj kontributit për lirinë e Kosovës, përpara se mjeshtri Sabri Behramaj të përfundojë punë dhe vepra e tij të vendoset në një nga pjesët më të frekuentuara të qytetit tonë", ka thënë Nura.

## Gjashtë raste të dhunës në familje në rajonin e Ferizajt

Ferizaj, 10 korrik - Në Policinë Rajonale të Ferizajt gjatë javës së kaluar, nga data 03-09/07/2023, janë raportuar gjashtë raste të dhunës në familje, të cilat kanë ndodhur në Ferizaj. Me vendim të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, një person është ndaluar në mbajtje për 48 orë, ndërsa pesë persona të tjerë janë liruar për procedurë të rregullt të mëtejme hetimore.
Policia Rajonale e Ferizajt rastet e dhunës në familje i ka trajtuar në mënyrë profesionale nga policë primarë dhe hetuesit rajonalë të Njësisë së Dhunës në Familje.
Policia u bënë thirrje qytetarëve t'i raportojnë rastet e dhunës në familje dhe i fton qytetarët të bashkëpunojnë me policinë.



## KQZ-ja fillon procesin e harmonizimit të rregulloreve zgjedhore me ligjin e ri të zgjedhjeve

**Prishtinë, 10 korrik** - Vetëm pak ditë pasi Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme u publikua në Gazetën Zyrtare, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka filluar procesin e harmonizimit të rregulloreve zgjedhore me këtë ligj.
Lajmi është dhënë nga zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, i cili ka thënë se pas miratimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nga Kuvendi i Kosovës, KQZ ka evidentuar ndryshime në çështje të caktuara të procesit zgjedhor.
Elezi ka treguar se çfarë do të përfshihet në harmonizimin e akteve nënligjore. “Në këtë proces të harmonizimit janë përfshirë disa rregullore zgjedhore të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin dhe funksionimin e partive politike; certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve; regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës; themelimin dhe ndërrimin e qendrave të votimit; fushatën e zgjedhjeve dhe vëzhguesit; regjistrimin dhe votimin e personave me nevoja të veçanta; këshillat e vendvotimeve; votimin dhe numërimin e fletëvotimeve; Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve dhe për Qendrat Komunale të Numërimit”, ka njoftuar Elezi.
Siç bëhet me dije nga KQZ-ja, pjesë e procesit janë edhe përfaqësues nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe nga Misioni i OSBE-së.



# Avokati i Popullit për Ligjin për Skemat Sociale: Të respektohet vendimi i Kushtetueses




**Prishtinë, 10 korrik** - Avokati i Popullit ka mbajtur debatin “Pensionet kontributpaguese - të drejtat e pensionistëve dhe kontributpaguesit e diskriminuar” pas miratimit të Ligjit për Skemat Sociale nga qeveria, vendim ky i marrë pas shpalljes së mendimit nga Gjykata Kushtetuese për projektligjin.
Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se të larguarve me dhunë nga puna në vitet ’90 u janë shkelur të drejtat. Ai ka kërkuar që për këtë çështje të respektohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe se ndryshimet në ligj mos të jenë diskriminuese sikurse tani.
“Çështjet për të cilat do të flasim sot janë fondi i pensioneve e detyrimi i shtetit. Në këtë drejtim konsideroj se e drejta e mohuar në dorën e autoriteteve duhet adresuar dhe shpresoj që pas këtij takimi do të arrijmë në konkluzione mbi këto çështje”, ka thënë Qelaj.
Ai ka shtuar se nëse i referohemi vendimit të Gjykatës Kushtetuese, atëherë çfarë duhet të ndodhë që të merren masat e nevojshme për këto çështje që i përmendi. “Janë rekomandimet; ndryshimi i ligjit në përputhje me Gjykatën Kushtetuese që të mos ketë më karakter diskriminues. Të fillohet të zbatohet ligji për familjarë dhe invalidë”, ka theksuar Qelaj.
Suzana Gashi, drejtoreshë e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi në këtë institucion, tha se shumë persona nuk kanë mundur ta dëshmojnë përvojën e punës për shkak të largimit të pavullnetshëm nga puna. Sipas saj, secili person që ka kaluar 65 vjeç ka marrë të njëjtën vlerë të pensione, pavarësisht a ka pasur përvojë të punës ose jo.
Ndue Kalaj nga Sindikata e ish-Nëpunësve Shtetërorë të Kosovës të viteve ’90 foli për rëndësinë dhe rolin e sindikatave dhe të shoqatave në zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe për bashkëpunimin me autoritetet shtetërore.

## Kurti viziton Ipeshkvinë e Kosovës, diskutohet për Ligjin për Liritë Fetare

**Prishtinë, 10 korrik** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vizituar të hënën Ipeshkvinë e Kosovës. Ai është mirëpritur nga Ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, imzot Dodë Gjergji dhe Don Lush Gjergji.
Në takim ata folën për Ligjin për Liritë Fetare, për bashkëpunimin e ndërsjellë, për kontributin e Kishës Katolike për paqe midis njerëzve dhe bashkim të njerëzve, por edhe për nevojën e rregullimit të statusit juridik të Kishës Katolike në Kosovë.
Kryeministri Kurti me këtë rast i falënderoi udhëheqësit e Ipeshkvisë së Kosovës për bashkëpunimin e afërt, kontributin e vazhdueshëm dhe rolin e rëndësishëm të tyre.
Ata biseduan edhe për vizitën e fundit që kryeministri Kurti zhvilloi në Vatikan, ku u prit nga Ati i Shenjtë, Papa Françesku dhe sekretari i Shtetit të Selisë së Shenjtë, Kardinali Pietro Paroli.
Kryeministri ndau me Ipeshkvin imzot Dodë Gjergji dhe Don Lush Gjergji mbresat e tij nga vizita në Vatikan dhe nga takimi me shenjtërinë e tij, Papa Françesku.
Më 22 qershor kryeministri Kurti kishte realizuar vizitën e tij të parë zyrtare në Vatikan. Në takimin me shenjtërinë e tij, Papa Françeskun, kryeministri Kurti kishte biseduar për rininë dhe ardhmërinë, për figurën, veprën dhe trashëgiminë e Nënës Terezë, për Letnicën e Vitisë ku asaj i erdhi thirrja për devocion, edhe për bashkëjetesën multifetare në Kosovë, si dhe e kishte ftuar atë ta vizitojë Kosovën.



# Qeveria e Kosovës ‘zbut’ masën e sigurisë për mallrat serbe




**Prishtinë, 10 korrik** - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për lehtësimin e masës së sigurisë ndaj mallrave me origjinë nga Serbia.

Oda Ekonomike e Kosovës ka konfirmuar se qeveria këto ditë ka marrë vendim për heqjen e masës së sigurisë vetëm për mallrat e lëndës së parë dhe gjysmëprodukte.

Kryetari i Odës, Lulëzim Rafuna, ka theksuar se OEK-u është i njoftuar për heqjen e masës së sigurisë për mallrat e lëndës së parë dhe gjysmëprodukte.

Ndërkaq nga Qeveria e Kosovës nuk janë përgjigjur lidhur me “zbutjen” e masës së sigurisë për mallrat serbe.

Qeveria e Kosovës më 14 qershor ka marrë vendim për t’i shtrënguar kontrollet kufitare me Serbinë. Ky vendim ka ardhur pas arrestimit të tre pjesëtarëve të Policisë së Kosovës nga forcat serbe.

Kryeministri Albin Kurti në një konferencë për medie pati thënë se qëllimi i këtij vendimi është të rritet kontrolli në kufij. “Për arsye të sigurisë, si hap i menjëhershëm dhe i domosdoshëm janë shtrënguar kontrollet kufitare me Serbinë, duke kufizuar qarkullimin dhe duke shtuar kontrollet ndaj automjeteve që vijnë nga Serbia, sidomos ato transportuese”, pati thënë Kurti.

Në katër komunat në veri të Kosovës që nga data 26 maj ka pasur zhvillime të njëpasnjëshme, serbët protestuan dhunshëm për disa ditë, ku tentuan të hyjnë me forcë në objektet e komunave. Grupe kriminale serbe sulmuan ushtarë të KFOR-it, policë dhe ekipe të medieve. Zhvillimet e fundit në veri kanë nxitur reagime të ashpra nga ndërkombëtarët të cilët edhe kërkuan nga Qeveria e Kosovës t’i ulin tensionet. /KP/

# Mbi 1.5 milion mërgimtarë erdhën në Kosovë, brenda gjashtë muajve u realizuan 10 mijë fluturime

**Prishtinë, 10 korrik** - Në gjashtë muajt e parë të vitit 2023, duke e shfrytëzuar Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, kanë ardhur dhe shkuar mbi 1.5 milion mërgimtarë. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar mbi 10 400 fluturime. Numri më i madh është nga Zvicra, ndjekur nga Gjermania, Turqia dhe Austria.

Sipas të dhënave të ANP “Adem Jashari” dërguar për “Telegrafi”-n, numri më i madh i mërgimtarëve ishte nga Zvicra, me 583 206 udhëtarë apo 38.24 për qind e numrit të përgjithshëm të udhëtarëve. Po ashtu, numër të lartë kishte dhe nga Gjermania me 517 863 udhëtarë, Turqia me 165 727 udhëtarë dhe Austria me 6.1 për qind të pjesëmarrjes së udhëtimeve.

Për sa i përket numrit të fluturimeve, nga Zvicra janë realizuar 3 750 udhëtime, pasuar nga Gjermania me 3 315, Turqia me 1 150 dhe Austria me 710 fluturime.

Numër më i madh i ardhjes dhe shkuarjes së mërgimtarëve është realizuar gjatë muajve prill dhe maj, ku kanë ardhur në total 586 157 udhëtarë me 4 040 fluturime.

Gjatë muajit janar janë 235 834 mërgimtarë me 1, 60 fluturime, në shkurt në vendin tonë kanë ardhur 193 116 udhëtarë me 1 238 fluturime, në muajin mars kanë ndodhur 1 496 fluturime me 221 760 udhëtarë, ndërsa në muajin qershor janë 289 919 udhëtarë me 2, 26 fluturime.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) tregojnë se gjatë vitit 2022 diaspora ka dërguar 59.4 milionë euro më shumë, shkruan “Telegrafi”.

Për këtë periudhë vlera më e lartë ishte gjatë muajit gusht me 131.6 milionë euro nga totali prej mbi 1.2 miliard eurosh.

Bazuar në kanalet e dërgimit, BQK-ja thotë se 702.1 milionë euro janë transferuar me anë të agjencive të dërgesave të parëve, kurse pjesa tjetër me anë të bankave komerciale dhe kanaleve alternative.

Ndërsa sa iu përket dërgesave të mërgatës sipas vendeve, Gjermania është shteti ku më së shumti dërgohen para në drejtim të Kosovës. Nga ky vend kanë ardhur 41.2 për qind e dërgesave, ndjekur nga Zvicra me 20.2 për qind dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me 9.1 për qind.



Banka Botërore thotë se pjesëmarrja e remitencave në Prodhimin e Brendshëm Bruto të Kosovës është rreth 20 për qind, ku nga shpallja e pavarësisë janë dërguar 13 miliardë euro.

Nga rezultatet preliminare të regjistrimit të diasporës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të Evropës dhe botës, të cilët i janë përgjigjur regjistrimit, është rreth 350 mijë.



## Hapet aplikimi për pagesa direkte në sektorin e blegtorisë

**Prishtinë, 10 korrik** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur aplikimin për pagesa direkte në sektorin e blegtorisë për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Ky afat do të jetë i hapur nga data 10 korrik deri më 18 gusht. “Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural vazhdon ta mbështesë sektorin e blegtorisë përmes pagesave direkte për qumësht/litër, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri, zogjtë për majmëri (brojlerët), dhe akuakulturë si dhe mbështetja për Primin e Sigurimeve bujqësore”, thuhet në njoftimin për medie.

# Të huajtë ç'kuitojnë për shqipëtarët



Nga FAIK BEJ KONICA

KUR flasin Shqipëtarët për të dreqtat e tyre e kur çuditen pse s'u a ve veshin kush, – harrojnë të pyesin shkakun e këtij mosndëgjimi. Kam dëshirën të rëfej këtu në pakë fialë se ç'mendojnë të huajtë për Shqipërinë.

Të parën gjë që thonë, është se Shqipëtari bën ç'të dojë, ay e urdhëron Turqërinë, ai e ka zotërimin përmi popujt e tierë që rojnë nënë krahë të Sulltanit. Këtë një të huaji nuk ia nxjerr dot nga kryet, sa do i ditur a i mënçur të jetë. Një ditë, flisja me disa atdhetarë, e qeshjim e çuditeshim si u përhap kjo gomarërië.

Pyetjim njëri tiatërin, kërkojim, nëmërojim. Shqipëtarët janë dy miliunash veta, do me thënë piesa e katër-mbë-dhiettë e popullit të Turqisë. Mirë. Tani në Turqië ka nj'a 80 vilajetë, do me thënë po t'ishin 6 valinj – e 14-ta piesë – Shqipëtarë, nukë do të qe tepër. E ku janë edhe ata të 6? Vetëm Abedin Pasha është vali shqipëtar sot për sot, 1! "Mytesarifër", në nj'a 250 qi qeverisin në Turqie, ka nj'a 7 Shqipëtarë vetëm. Mushir, vetëm Rexhep Pasha, në Tarabullus. Generallë, në tre-katër qint, janë nj'a 10 Shqipëtarë. Në diplomësie, përveç një kryeshkronjëtor, të gjitha vendet e mira janë për Turq, për Grekër e për Armenë. Mua nuk më vien keq fare, për kundrë më pëlqen t'i dbojë Sulltani të gjithë Shqipëtarët pakë nga pakë, se ahere do të zënë të mësojnë mënt. Po ku hidhërohem, që, duke qen' ashtu puna, të shoh njerës të bërtasin që Shqipëtarët i kanë të gjitha vendet e mira!…

Pse thonë gjëra të pavërteta? Pse s'mundohen gjysm'ore e të kuptojnë se janë në gabim? Pse nukë njohin se në ka shumë Shqipëtarë në punë të qeverisë, janë për vendet e unjta, zaptienj, çaushë, etj, vënde ku s'mundin të "zotërojnë" një mbretërië?

Këto që thonë për Shqipëtarët, shumë të huaj i thonë për të bërë lirisht propagandën sllave të tyre; po disa i thon' edhe se me të vërtet ashtu u duket. Këtyreve, u është mbushur kryet që Shqipëtarët bëjnë si të duan, se nukë njohin nga Shqipëria përveç disa qëntre të Shqipërisë së sipërme, ku më të vërtet Shqipëtarët janë miaft të lirë. Po tërë Shqipëria? Po qindëra vise të tiera? Po gjithësia e kombit tonë? A kanë, jo më tepër, po dhe aqë të drejta sa kombet e tierë të Tuqisë

Ku e kemi edhe ne lirinë e mësimit – lirinë të cilën nukë do të lodhemi së kërkuari, se ajo është shpëtimi i kombit t'onë. Ku e kemi? Është gjë e vështirë për të besuar që, kur një Shqipëtar si Naçi lëngon në burg vetëm se dha mësime në një shkollë të hapur me leje, të jenë njerës të thonë se Shqipëtari bën ç'të dojë!…

E dyta gjë që thonë të huajtë, është se Shqipëtari është përtac, e "zanati" i tij është të rojë duke viedhur fqinjët. Kundrë kësaj gënjeshtre, ka shtat viet që po protestojmë këtu, dhe kemi shkruar shumë herë te piesa frëngjishte e ALBANIËS.

Vërtet, zaptiellëku është plaga e vendit t'onë; po të pakë janë ata, a nukë nëmërohen me mijëra, qi në Turqie, në gjithë Ballkan e në vise të tiera venë, për të fituar me nder një copë bukë, të punojnë tërë ditën?

E treta fialë e të huajve kundrë Shqipëtarëve është që populli ynë është "fanatik" e i egër në punë të fesë. Edhe këtu, janë gjykime të lehta përmi kombin e tërë Shqipërisë 'pas sa bëjnë disa Shqipëtarë të pakë të kufive. Fanatismin Shqipëtari nuk e ka as katër herë mê pakë se kombet e tierë të Ballkanit. Është për të vënë re se librat e shkruara nj'a njëzet viet më parë – e ca më tepër ato më të vietërat – i rëfejnë Shqipëtarët për njerës pa fanatism e pa egërsië kundrë atyreve të feve të tiera. Po sot që Bullgarët zunë me propagandat e tyre, të shpifurat e të huajve zunë t'u mohojnë Shqipëtarëve edhe atë të vetëmën të mirë që kush s'u a kish mohuar. / *"Albania", Korrik 1903*




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Daja dhe Thaqi: Vështirë ndaj Ludogoretsit, por nuk dorëzohemi

Trajneri Ilir Daja dhe futbollisti Armend Thaqi në konferencën para ndeshjes ndaj Ludogorets e kanë pranuar se do të jetë vështirë, por janë optimist se do të nxjerrin një rezultat të favorshëm. Madje, trajneri shqiptar ka shkuar edhe me larg duke bërë me dije se skuadra kampione e Kosovës nuk do të mbrohet në këtë ndeshje. Përballja Ballkani-Ludogorets zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 10 korrik - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani e ka përfunduar stërvitjen e fundit para ndeshjes kualifikues për Ligën e Kampionëve ndaj skuadrës bullgare Ludogorets. "Ekipi është gati për ndeshjen e nesërme, ku e presim përkrahjen e secilit prej jush, pasi gjithmonë bashkë jemi më të fortë. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Suhareka. Ndeshja mes djelmoshave që drejtohen nga trajneri Ilir Daja dhe skuadrës bullgare zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" nga ora 20:45. Trajneri Daja e pranon se ndeshja do të jetë shumë e vështirë, por ka bërë me dije se skuadra e tij do të bëjë të njëjtën lojë si gjithmonë dhe nuk do të parkojnë autobusin pavarësisht se kush është kundërshtar. "Na pret një ndeshje e vështirë, por ndeshjet e vështira nganjëherë janë më të bukura për të luajtur sepse nuk ke të bësh me motivimin e lojtarëve, por vetëm me fokusimin e tyre në ato detyrat taktike. Do të bëjmë të njëjtën lojë si gjithmonë. Kemi disa mënyra për t'u përball me kundërshtarin. Ekipi ka respekt për kundërshtarin, por edhe vetën. Kemi një grup që ka eksperiencë historike në futbollin e Kosovës. Kemi po atë 11-she, përveç Ermal Krasniqit që nuk është më pjesë e jona dhe po shkëlqen atje ku ka shkuar. Siç kam thënë, nuk do të parkojmë autobusin ndaj asnjë kundërshtari që kemi përballë", ka thënë Daja. "Është e vështirë të flasë tani, por edhe në këtë pjesëmarrje mendojmë që të bëjmë më të mirën e mundshme. Jemi përgatitur në maksimum. Kemi bërë një fazë përgatitore gati një muaj, ekipi është në formën e duhur. Çdo lojtar e ka për detyrë të jep më shumë se potenciali i vet, të jep shpirtin në fushë kur ke një kundërshtar të fortë", ka shtuar Daja. Për ndeshjen ndaj Ludogorets ka folur edhe mbrojtësi Armend Thaqi. Ky i fundit e pranon se Ballkani do ta ketë më të vështirë sivjet, pasi vitin e kaluar e kanë njohur me pak. "Pas vitit të kaluar që kemi shkruar historinë, mendoj që ky vit do jetë më i vështirë, sepse vitin e kaluar na kanë njohur pak, këtë vit na shohin me sy tjetër. Tani na konsiderojnë shumë më të fortë se vitin e kaluar, do jetë e vështirë të përsërisim suksesin, kemi kundërshtar të vështirë – shpresojë të kemi fat dhe ta fillojmë mbarë. Assesi nuk do të dorëzohemi, duam ta tregojmë veten dhe të tregojmë sa vlejmë", ka thënë Thaqi.

## SHKURT

### Hodaj vazhdon me Lirinë

Gardiani i portës së Lirisë, Drilon Hodaj, ka vazhduar edhe për një vit kontratën me klubin prizrenas. Hodaj, që në ndeshjen e barazhit me Ferizajn ishte figura qendrore, ka refuzuar disa oferta dhe është përcaktuar për ekipin e zemrës, Lirinë. "Jam i lumtur për akordin. Bashkë me shokët e skuadrës do ta jap maksimumin për klubin e fëmijërisë", ka thënë Hodaj pas nënshkrimit të kontratës.

### KB Ylli rikthen Bekteshin

KB Golden Eagle Ylli po vazhdon përforcimet për sezonin e ardhshëm. Klubi nga Suhareka ka njoftuar se e ka kthyer basketbollistin Besnik Bekteshi. "Besnik Bekteshi kthehet të luajë në Kosovë pas një karriere mjaft të mirë në Gjermani me ekipe si VfL Kirchheim Knights, Tigers Tubingen, RheinStars Koln etj. Mirë se vjen, Besnik!", thuhet në njoftimin e Yllit.
Kampioni i dyfishtë i Kosovës e ka rikthyer edhe Arbër Berishën.

### Vëllaznimi 'blindon' edhe katër futbollistë, rikthen Vokshin

KF Vëllaznimi po vazhdon risitë për sezonin e ri futbollistik 2023/2024. Klubi kuqezi ka vazhduar kontratat me Driton Hana, Fluid Syla, Gentrit Bislimi dhe Igan Lleshi. Klubi gjakovar në radhët e veta e ka rikthyer Ardit Vokshi. "Ardit Vokshi ka nënshkruar kontratë me KF Vëllaznimin për sezonin 2023/24. Arditi i bashkohet KF Vëllaznimit nga FC Phoenix", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit.

### Xhudo demonstrohet me nxënësit e 'London School' në Mitrovicë

Nxënësit e "London School" u bashkuan në stërvitjen e mëngjesit në kuadër të programit "Kosova, shtet i xhudos", ku fillimisht realizuam një bashkëbisedim me nxënësit dhe trajnerin e Klubit të Xhudos "Trepça", Blenard Begu, i cili foli për rëndësinë e sportit të xhudos në shëndetin fizik dhe atë mendor. Më pas vazhduan ushtrimet, ku të inkuadruar ishin edhe nxënësit, të cilët së bashku me xhudistët Blerina Gashi, Uvejs Nesimi, Reis Deliu dhe Riad Kasapi u angazhuan në gjimnastikë dhe në teknikat bazë të xhudos. Nxënësit treguan shumë kureshtje dhe angazhim gjatë demonstrimeve, kurse disa edhe shprehën dëshirë të bëhen pjesë e klubeve të xhudos. Programi shtetëror, "Kosova, shtet i xhudos", përmes komponentit, "Xhudo në shkolla - xhudistët e rinj", ka për qëllim ta zhvillojë masivizimin dhe integrimin e disiplinës së xhudos në të gjitha shkollat dhe komunat e Kosovës.

## Gjilani huazon dy futbollistë nga Kukësi

